



Datë: 17.11.2025
Numër Protokolli: 7407/2025

A.nr.1631/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare; Eshref Shabani dhe Malsore Gashi, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1631/2025, të datës 28.08.2025, të parashtruar nga ankuesja A.U-Ll, kundër organit të punësimit: Qendra e Studentëve, me objekt kontesti *‘Kontestim konkursi’*, në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 17.11.2025, mori këtë.

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1631/2025, të datës 27.08.2025, të parashtruar nga ankuesja, A.U-Ll.

A r s y e t i m

Ankuesja A.U-Ll (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 27.08.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së pranimit me numër reference RPC0011606, për pozitën e punën e punës *‘Zyrtar për Inspektim të Brendshëm’*, të shpallur nga Qendra e Studentëve në Prishtinë, ndërsa, e njëjta, më datë 17.11.2025, përmes parashtrësës së dorëzuar në formë elektronike është tërhequr nga ankesa me numër protokolli 5727/2025, të datës 27.08.2025.

Andaj, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *‘Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë’*, vendosi për përfundimin e procedimit administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1631/2025, të datës 27.08.2025, pasi që nga kërkesa e datës 17.11.2025 rezulton se ankuesja nuk ka interes juridik që të vazhdoj me këtë procedurë administrative.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1631/2025

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetarja e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, A.U-Ll;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Qendrën e Studentëve; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.